



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

APS.nr.20/2021

GJYKATA E APELIT NË KOSOVË – Departamenti Special, në Kolegjin Penal të përbërë nga gjyqtarët, Tomisllav Petroviq – Kryetar i kolegjit, Burim Ademi dhe Bashkim Hyseni anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Alba Makolli, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.Ç., N.L., S.H. , SH.D., Q.G., SH.B., A.D., RR.B., F.F., S.E., F.SH. dhe XH.J. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.230/18 të dt.16.04.2021, me datë. 21.03.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Kosovës ndërsa, ANULOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 230/2018 i datës 16.04.2021, dhe lënda kthehet në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda ka marrë aktgjykimin PKR.nr.230/18 të dt.16.04.2021, me të cilin të akuzuarit A.Ç., N.L., S.H. , SH.D., Q.G., SH.B., A.D., RR.B., F.F., S.E., F.SH. dhe XH.J. janë liruar nga akuza për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

E dëmtuara Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet procedurale bien në buxhet të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi Prokuroria Speciale ka parashtruar ankesë PPS.nr.12/2018 të datës 05.05.2021 për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të aprovohet ankesa, ndërsa aktgjykimi të ndryshohet dhe provat të çmohen, vërtetohen dhe vlerësohen në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe të akuzuarit të shpallen fajtor, apo të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit A.Ç. avokati Ramë Gashi, me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë dhe aktgjykimi të vërtetohet.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit N.L. avokati Tahir Rrecaj, me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë dhe aktgjykimi të vërtetohet.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit Q.G. avokati Gafurr Elshani, me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë dhe aktgjykimi të vërtetohet

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit RR.B. avokati Artan Qerkini, me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë dhe aktgjykimi të vërtetohet

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit S.E. avokati Nysret Islami, me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë dhe aktgjykimi të vërtetohet

- Prokuroria e Apelit në Prishtinë, ka paraqitur parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.207/21 të datës 27.05.2021, me të cilën ka propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës si të bazuar dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshojë, ashtu që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të gjykohen sipas

ligjit ose aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa të refuzohen përgjigjet në ankesa të mbrojtësve të akuzuarve A.Ç. avokati Ramë Gashi, N.L. avokati Tahir Rrecaj, RR.B. avokati Artan Qerkini, Q.G. avokati Gafurr Elshani dhe S.E. avokati Nysret Islami, si të pabazuara.

Gjykata e Apelit ka mbajtur seancën e kolegjit pa prezencën e palëve, meqenëse kemi të bëjmë me aktgjykim lirues.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore te Prokurorisë, dhe përgjigjeve në ankesë, propozimin e Prokurorisë së Apelit, duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës është e **bazuar**.

1. Pretendimet ankimore të Prokurorisë:

Prokuroria Speciale e Republikës e Kosovës, pretendohet se gjykata e shkallës së parë ka bërë gabimisht vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike, përkundër faktit se janë ofruar dhe administruar prova të mjaftueshme, të cilat po të vërtetoheshin saktë dhe drejtë do të provohej se në veprimet e të akuzuarve manifestohen elementet e veprës penale. Sipas ankesës, pretendimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me mos vërtetimin e periudhës kohore të veprimeve inkriminuese të akuzuarve nuk qëndron, për faktin se me provat e propozuara vendimet e Qeverisë nr.03/58 të dt.27.01.2021 dhe nr.06/13, gjykata saktë ka mundur të vërtetojë periudhën kohore për secilin anëtar komisioni. Është e vërtetë se jo të gjithë anëtarët e KVSH-së, janë emëruar në të njëjtën periudhë kohore, mirëpo ky fakt nuk paraqet bazë që të lirohen nga përgjegjësia penale të akuzuarve edhe për periudhat kohore sa kanë qenë duke e ushtruar detyrën zyrtare në cilësinë e anëtarëve të KVSH-së. Sa i përket kohës kur të akuzuarit kanë kryer veprimet inkriminuese dhe përshkrimi i periudhës së saktë, ka mundur të vlerësohet si pengesë nga gjykata. Sipas pretendimeve në ankesë, theksohet se është vërtetuar bindshëm se verifikimi dhe njohja është dashur të bëhet në bazë të Ligjit nr.04/ L-261 për Veteranët e Luftës së UÇK-së, andaj nuk qëndron konstatimi i gjykatës se nuk është vërtetuar se në bazë të cilit ligj është bërë kategorizimi i statusit të veteranit luftëtar. Nuk është kontestuese se procesi ka filluar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji nr.04/L-054, mirëpo me këtë ligj është parashikuar nxjerrja e një ligji të veçantë për tu rregulluar dhe përcaktuar kriteret dhe

beneficionet e veteranëve të UÇK-së. Prokuroria konsideron si të gabuar konstatimin e gjykatës se kanë qenë dy ligje në fuqi, për faktin se zyra ligjore në kuadër të zyrës së Kryeministrit, ishte obliguar që të bëjë ndryshim ligjor lidhur me ndarjen në kategoritë e dala nga lufta, për çka kishte hyrë në fuqi Ligji nr. 04/L-261, për çka edhe të akuzuarit F.F. dhe A.Ç. kishin marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit të Kuvendit lidhur me rekomandimet përkitazi me këtë ligj. Gjithashtu, prokuroria i është referuar edhe Ligjit nr.04/L-172 i cili ishte miratuar bashkë me Ligjin nr.04/L-261 ku në nenin 4 shprehimisht thuhet se në nenin 3 të ligjit bazik fshiheshin nën paragrafët 1.9, 1.11 dhe 1.13., dhe është pikërisht pika 1.9 e Ligjit nr.04/L-054 ku përkufizimi i veteranit luftëtar, parashihej ndryshe e cila pikë shfuqizohet dhe bëhet riformulimi i pikës 1.7 lidhur me përkufizimin e veteranit të UÇK-së, e që është i njëjti me përkufizimin në Ligjin nr.04/L-261. Më tutje theksohet, se përkundër kësaj gjykata e shkallës së parë gabimisht i është referuar Ligjit nr.04/L-054 nenit 3 pikës 1.9, se kinse të akuzuarit kanë pasur dilema. Ndërsa, anëtarët e komisionit fare nuk kishin dilema sepse në vazhdimësi i ishin referuar dispozitave të këtij ligji me rastin e kategorizimit të aplikantëve për kategoritë përkatëse, për çka prokurori i referohet mbledhjes së dt.24.07.2015 dhe kështu konsideron se për të akuzuarit fare nuk ka qenë diskutabil ligji i zbatueshëm. Më tutje, theksohet se nga procesverbalet e mbledhjeve të KVSH-së, sipas prokurorisë të akuzuarit kanë qenë në dijeni se mandatin e tyre ligjor për verifikimin e listave të veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, invalidëve dhe dëshmorëve nuk janë duke e kryer në përputhje me ligjin, pra janë duke shkelur kriteret në përmbushjen e të cilave një aplikanti i pranohet statusi që pretendon. Kështu, theksohet se “mendimet e lira”, të cilave i konstaton gjykata e shkallës së parë, sipas prokurorisë janë shumë të rëndësishme në vërtetimin e dashjes dhe dijenisë të akuzuarve se janë duke vepruar në kundërshtim me ligjin. Veçanërisht, i është referuar procesverbalit të datës 29.12.2014, fjalëve të akuzuarve SH.D., pastaj të akuzuarit F.F. në procesverbalin e dt.02.03.2015 dhe të akuzuarit SH.B., ku vet të akuzuarit kanë qenë në dijeni me parregullsitë dhe problemet që i kishin bërë gjatë procedurës së verifikimit. Në anën tjetër, sipas ankesës theksohet se qëllimi i ekzistimit të komisionit ka qenë verifikimi / shqyrtimi i aplikacioneve dhe njohja e statusit të kategorive të veteranëve, andaj mbetet e paqartë konstatimi i gjykatës se nuk u vërtetua saktë obligimi ligjor i KVSH-së. Se qëllimi ka qenë i ditur, vërtetohet nga vet emërtimi i komisionit në pajtim me rregulloren nr.23/2013, në të cilën përcaktohet edhe emërtimi. Se verifikimi/shqyrtimi ka qenë kompetencë e komisionit vërtetohet edhe nga deklaratat e dëshmitarëve RR.R. dhe A.RR.. Kundërthëniet e trupit gjykues janë evidente kur e merr si të mirëqenë këtë rrethanë, ndërsa në një moment vlerëson se komisioni nuk ka pasur për obligim verifikimin/shqyrtimin e aplikacioneve dhe njohjen. Ankesa iu referohet edhe

procesverbaleve të shqyrtimit gjyqësor të datave 5 dhe 6 dhjetor 2019 dhe kundërthëniet të gjykatës, duke asgjësuar çfarëdo besueshmërie në konstatimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike. Më tutje, theksohet se dispozitat ligjore të rregullores nr.23/2012, respektivisht nenit 12 dhe 15, nuk i kanë mundësuar komisionit që të drejtën dhe obligimin për verifikim ta bartë tek personat tjerë, të cilëve trupi gjykues iu referohet si “zinxhiri komandues” dhe pastaj “që ta përmbyllin procesin si të tillë”, për shkak të kohës së shkurtër që iu kishte mbetur”, konstatime këto të bëra në faqen 55 të aktgjykimit. Më tutje, theksohet se nuk qëndron konstatimi i gjykatës, se nuk u vërtetua baza ligjore që i obligonte të akuzuarit, e që sipas prokurorisë baza ligjore ekzistonte me rregulloren 23/2012 dhe ligjin nr.04/L-054, ku rregullohen detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit. Gjithashtu, prokuroria nuk pajtohet me përfundimet e gjykatës e cila ndalon lëshimin e certifikatave derisa nuk është aprovuar lista përfundimtare, e cila ndalesë parashihet me nenin 8 par.1 të Ligjit nr.04/L-261. Prokuroria, pretendon se trupi gjykues, nuk ka trajtuar faktin se të akuzuarit kanë filluar me lëshimin e certifikatave pa miratimin e listës përfundimtare, gjë që është shkelje e ligjit. Gjithashtu, si të pabazuar e gjen edhe konstatimin e gjykatës se nuk ka mundur të dëshmohet se të akuzuarit a ishin në kompetencë të verifikonin secilin aplikacion, kur sipas ankesës kjo rrethanë nuk ka qenë kontestuese ku faqja 3 ishte rezervuar për nënshkrim e cila ka qenë obligim, të cilin të akuzuarit nuk e kanë përmbushur. Sipas ankesës, të akuzuarit në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit nr.04/L-261 dhe rregullores 23/12, kanë vendosur që shqyrtimin e ankesave ta bëjnë personat e njëjtë të cilët kishin bërë verifikimin e aplikacioneve në fazën e parë duke iu dhënë mundësi për manipulime dhe rritje të numrit të veteranëve. Prokuroria gjen se procedura e shqyrtimit të ankesave buron nga ligji respektivisht neni 7, por edhe me rregulloren e cila parasheh një komision të posaçëm, e kundër vendimit të këtij komisioni parashihet e drejta e ankesës. Gjykata, ka anashkaluar dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore dhe i referohet një projekt rregulloreje të dt.02.03.2015, e cila nuk ka qenë fare e miratuar dhe prokuroria konsideron si të pakuptueshme anashkalimin e ligjit dhe rregullores nga ana e gjykatës dhe referimit të saj në një projekt – rregullore. Sipas prokurorisë, nuk mund të tregohet objektiviteti kur organi vendos për ankesat kundër vendimeve të veta, fakte të cilat gjykata i ka anashkaluar. Gjithashtu, prokuroria i referohet edhe konstatimit të gjykatës që ka të bëjë me mandatin e KVSH, i cili ka përfunduar me datë 13.05.2015, e që sipas prokurorisë gjykata anashkalon mbledhjet e vazhduara të komisionit duke marrë vendime dhe gjykata fare nuk arsyeton se në çfarë cilësie kanë vepruar të akuzuarit, përderisa kanë vazhduar të jenë pjesë e komisionit. Më tutje, sipas ankesës së Prokurorisë Speciale, theksohet se nuk pajtohet me konstatimet e gjykatës që kanë të bëjnë me faktin se komisioni ia ka lënë mundësinë qeverisë të veprojë nëse

ka dyshime se procesi nuk ishte në rregull. Sipas ankesës, rrethana e tillë vë në dyshim “qëllimin e mirë” të komisionit, të cilët nuk kanë treguar faktin se listat janë fryrë dhe numri ka dal më i madh, që sipas gjykatës është gjetur se fryrja nuk është pasojë e veprimeve inkriminuese të akuzuarve. Më tutje, prokuroria nuk pranon as konstatimin e gjykatës, që ka të bëjë me faktin se numri prej 19.500 aplikuesve a janë vërtetë përfitues të kundërligjshëm dhe se anëtarët e komisionit kanë vepruar në pajtim me ligj, sipas ankesës konstatimet e tilla nuk kanë mbështetje në dispozitat ligjore. Për më tepër, gjykata mjaftohet me shprehje të pakuptimta, sepse sipas ankesës komisioni përkundër shqetësimeve dhe dijenisë për fryrje vendosi për miratimin e listës përfundimtare.

Lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, theksohet se shkeljet e tilla konsistojnë nga neni 384 par.1 pika 1.12, ashtu që aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të KPP-së. Nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron si të vërtetuara. Kundërthëniet e shumta, gjenden sidomos në faqen 67 të aktgjykimit, sepse gjykata i referohet dispozitave ligjore lidhur me shqyrtimin e ankesave dhe në anën tjetër shërbehet me një projekt rregullorë. Gjithashtu, si kontradiktë e konsideron edhe konstatimin e gjykatës që ka të bëjë me formularët me të cilët do të bëhej verifikimi dhe njohja e statusit të kategorive të dala nga lufta, që sipas gjykatës konstatohet se nuk është provuar obligimi që faqen tre ta nënshkruajnë anëtarët e komisionit, ani pse e provon se faqja e tretë ishte e dizajnuar për tu nënshkruar nga të akuzuarit, përkatësisht se aplikacioni është përgatitur nga komisioni. Më tutje, lidhur me numrin e madh të përfituesve sa nga ishte pritur, gjë që e kishte vërejtur kryetari i KVVSH-së, rrethanë të cilën e konstaton gjykata dhe në anën tjetër konstaton se komisioni punën e kishte kryer në suaza ligjore. Lidhur me përmbylljen e listave, sipas gjykatës një gjë e tillë arsyetohet me kohën e shkurtër që i kishte mbetur komisionit, ndërsa në anën tjetër provat materiale që kanë të bëjnë me listat e vjetra të periudhave të ndryshme të zonave operative, i vlerëson si jo relevante. Më tutje, theksohet se konstatimet e gjykatës në njërin anë se nuk mund të vërtetohet a kemi të bëjmë me proces të rregullt apo të kundërligjshëm, ndërsa në anën tjetër, se veprimet e të akuzuarve kanë qenë të ligjshme, janë një kontradiktë e hapur në aktgjykim. Më tutje, theksohet qëllimi i të akuzuarve, e që gjykata mbetet e paqartë se çka ka vërtetuar duke u bazuar në angazhimin e tyre. Lidhur me lëshimin e certifikave para përmbylljes së fazës së procedurës ankimore personave që nuk ishin subjekt i ankesave, sipas ankesës gjykata fare nuk i referohet nenit 8 par.1 të Ligjit nr.04/L-261. Prokuroria nuk e pranon si të drejtë as konstatimin e gjykatës, që ka të bëjë me atë të zbatimit të ligjit dhe se prokuroria nuk kishte arritur të vërtetojë, e që sipas ankesës mbetet

e paqartë se të akuzuarit nuk e kanë zbatuar nenin 6 të Ligjit nr.04/L-261, pasi që kanë pasur dilemë, meqenëse në fuqi ka qenë edhe Ligji nr.04/L-054, i cili nuk ka përcaktuar qartë se si të bëhet kategorizimi.

Me ankesën e Prokurorisë Speciale, pretendohet se është shkelur edhe ligji penal respektivisht dispozita e nenit 422 të KPRK-së, në dobi të akuzuarve kur është vlerësuar se të njëjtit nuk kanë konsumuar veprën penale. Sipas ankesës, theksohet se gjykatës i janë ofruar prova të mjaftueshme dhe bindëse që do të sjellin në përfundim se kualifikimi ligjor që iu vihej në barrë të akuzuarve ka qenë adekuat. Duke pasur parasysh, peshën e veprës penale dhe vlerën e dëmit që i është shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës, është rrezikuar siguria juridike dhe parimet bazë të drejtësisë. Të akuzuarit, i kanë ditur detyrimet dhe autorizimet ligjore, të cilat u janë dhënë si komision qoftë sa i përket zhvillimit të procesit të verifikimit, pra shqyrtimit të secilit aplikacion, të cilat detyrime i kanë bartur tek personat tjerë, ndërsa që e kanë shfrytëzuar mundësinë që u ka dhënë ligji dhe kanë vendosur për miratimin e listave. Sipas ankesës, gjykata konstaton se të akuzuarit kanë shprehur shqetësime se listat janë fryrë dhe përkundër kësaj të akuzuarit kanë vendosur të iu shmangen detyrimeve ligjore për të gjitha veprimet që është dashur ti kryejnë deri në momentin e miratimit të listave. Të akuzuarit me dashje në cilësinë e personave zyrtarë nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare dhe kanë tejkaluar kompetencat zyrtare, duke iu sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm në dëm të Republikës së Kosovës. Sipas ankesës, të akuzuarit në cilësinë e anëtarëve të komisionit kanë qenë të ngarkuar me autorizime ligjore për njohjen dhe verifikimin e statusit dhe të drejtat e dëshmorëve të kombit, veteranëve, invalidëve, të internuarit si dhe pjesëtarët e UÇK-së, proces që është dashur të bëhet në përputhje me bazën ligjore, duke bërë shqyrtimin e secilit aplikacion të përgatitur dhe dizajnuar nga vetë komisioni, gjë që të akuzuarit nuk e kanë bërë, ashtu që nuk e kanë kryer fare procesin e verifikimit/shqyrtimit, por që kanë vendosur në mënyrë të kundërligjshme që këtë obligim ta bartë tek “zinxhiri komandues”. Gjithashtu, në mënyrë të njëjtë kanë vendosur që shqyrtimin e ankesave ta bëjnë personat e njëjtë të cilët kishin bërë verifikimin e aplikacioneve në fazën e parë, pra nuk i kanë kryer detyrat që është dashur ti kryejnë dhe kanë vendosur shpërndarjen e certifikatave para përfundimit të procesit të ankesave dhe para miratimit të listave përfundimtare, duke iu mundësuar 19,500 personave të marrin pension për kategoritë e cekura, duke i shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës dhe duke vepruar me dashje të drejtpërdrejt. Vet gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se të akuzuarit ishin në dijeni se ishte rritur numri i përfituesve të kategorive të dala nga lufta, por një gjë të tillë nuk e gjen si dashje, e që për prokurorinë nga rrethanat objektive në të cilat kanë vepruar të akuzuarit,

kanë qenë të vetëdijshëm se janë duke vepruar në kundërshtim me ligjin dhe me pasojat e shkaktuara, çka vërtetohet edhe nga procesverbalet e mbledhjeve të komisionit, pohim i cili ishte bërë edhe nga vet kryetari i komisionit tani i akuzuari A.Ç.. Sipas ankesës, prokuroria nuk pajtohet me vlerësimin e interpretimit të bashkëkryerjes, ku njëkohësisht sqaron nenin 31 të KPRK-së, e që në rastin konkret të akuzuarit kanë vepruar me të drejta dhe përgjegjësi të njëjta si organ kolegjal, duke bashkëpunuar në aspektin objektiv dhe subjektiv dhe kanë ndërmarrë veprime ashtu që me vetëdije nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare dhe kanë tejkaluar kompetencat zyrtare dhe kanë qenë të vetëdijshëm se janë duke vepruar në kundërshtim me ligjin dhe pasojat të cilat janë duke i shkaktuar.

Si përfundim, prokuroria ka theksuar se është vërtetuar se të akuzuarit në procesin e verifikimit dhe njohjes së statusit të veteranit luftëtar, kanë gëzuar statusin e personit zyrtar, me dashje nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare dhe kanë tejkaluar kompetencat zyrtare me qëllim që të tjerëve të iu sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, në dëm të buxhetit të Republikës së Kosovës. Se veprimet inkriminuese i kanë kryer në bashkëveprim, se veprimet i kanë ndërmarrë përkundër se kanë qenë të informuar për të gjitha devijimet, parregullsitë dhe mos respektimin e legjislacionit në fuqi nga ish zonat operative dhe njësitë vartëse në terren dhe lëshimet kanë rezultuar me rritjen e numrit të veteranëve të UÇK-së, se përgjegjësinë e kishin bartur tek zinxhiri komandues dhe nuk kanë verifikuar asnjë aplikacion të aplikuesve për statusin e veteranit të UÇK-së, se kishin injoruar nënshkrimin e faqes tre të aplikacioneve, se para përfundimit të procesit të ankesave kishin filluar shpërndarjen e certifikatave dhe në fund të procesit kanë aprovuar numrin e përgjithshëm prej 46.230 veteran luftëtarë të UÇK-së dhe si pasojë e këtyre veprimeve kanë shkaktuar dëm material buxhetit të Kosovës. Andaj, nëse gjykata gjen hapësirë dhe bazë ligjore për të vendosur në mënyrë meritore duhet ti shpallë fajtor të akuzuarit në përputhje me qëllimin e dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së dhe konform nenit 465 të KPP-së, të urdhërojë anulimin e vendimit të Komisionit për njohjen e statusit të veteranit luftëtar të UÇK-së, për përfituesit e paraparë në shtojcën 1 të aktakuzës. Për të gjitha, këto arsye ka propozuar si më lartë.

2. Pretendimet ankimore të përgjigjeve në ankesa të mbrojtësve të akuzuarve

Në përgjigjen në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të paraqitur nga mbrojtësi i të akuzuarit A.Ç. avokati Ramë Gashi, theksohet se të gjitha pretendimet e ankesës lidhur me bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, janë të

paqëndrueshme, jo të argumentuara dhe të pabazuara dhe një ri përsëritje e pretendimeve nga akuza dhe fjala përfundimtare. Ndërsa, lidhur me pretendimet e shkeljeve esenciale të njëjtat arsye janë dhënë në aktgjykimin e ankimuar, ashtu si edhe për shkelje të ligjit penal. Nga provat e caktuara nga aktakuza, nuk u vërtetuan pretendimet e aktakuzës në raport me të akuzuarin A.Ç., i cili sipas vendimit të dt.27.01.2012, ishte kryesues i Komisionit për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të UÇK-së, veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të UÇK-së. Që nga data 21.11.2012 e deri me datë 17.05.2016, i akuzuari ishte kryesues i komisionit, i cili komision kishte bërë raport në lidhje me përfundimin e listave për kategorinë e veteranëve, që më pas Qeveria e Kosovës me dt.01.06.2016, kishte marrë vendim për aprovimin e raportit të komisionit. Paraprakisht, Qeveria kishte marrë vendim me datë 13.05.2016, me anë të cilit kishte obliguar komisionin që deri më 20 maj 2016, ta përmbylli procesin e punës dhe të ia dërgojë qeverisë, ku i referohet si provë vendimit të qeverisë të dt.13.05.2016. Pretendimet e aktakuzës, si numri prej 19.500 personave si veteranë jo të ligjshëm u prodhuan nga një regjistër i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale sepse asnjë dëshmitar nuk ka dhënë deklaratë për numrin e personave që kishin qenë në luftë. Aktakuza konsiderohet si tejkalimi i autorizimeve dhe ndërhyrje derisa procesi i verifikimit nuk kishte përfunduar dhe bie në kundërshtim edhe me Ligjin nr.04/L-261 për Veteranët e UÇK-së. Kështu, theksohet se i akuzuari me asnjë veprim nuk kishte pasur kontribut në rritjen e numrit të veteranëve apo fryrjen e listave, sepse nuk ishte i angazhuar në terren por të dhënat arrinin nga terreni përmes Komandantëve të Zonave Operative. Komisioni kishte përmbushur detyrat e tij duke dërguar listat tek Qeveria e Kosovës, ashtu siç ishte formuar. Nuk mund të bëhej auditim i aplikimeve që dilnin nga terreni, sepse një gjë e tillë nuk i takonte komisionit, por në rast dyshimi vetëm Qeverisë të Kosovës. Në rastin konkret, assesi nuk përmbushen elementet e veprës penale ku mbrojtësi shpjegon dispozitën ligjore dhe konsideron, se i akuzuari në asnjë mënyrë nuk u provua që nuk ka vepruar me dashje dhe nuk përmbushur standardi ligjor për keqpërdorim i detyrës. Komisioni, me ligj nuk kishte kompetencë për verifikimin e dokumentacionit të aplikuesve dhe për aplikuesit të cilët në kundërshtim me ligjin kishin përfituar beneficionin e caktuar, ligji parashihte se do të ndaloheshin beneficionet, sepse në fund të fundit përgjegjësia penale është personale. I akuzuari nuk e ka pasur mundësinë të i njoh aplikuesit veç e veç dhe nuk ka pasur kontakte, apo bisedime dhe udhëzime. Andaj, i akuzuari me të drejtë është liruar në mungesë të provave, duke qenë se si kryesues i komisionit nuk ka pasur asnjë lidhje apo ndikim me punën në terren. I gjithë dokumentacioni për secilin aplikues të Zonës Operative, nënshkruhet nga eprorët e zingjirit komandues deri tek Komandanti i Zonës Operative, i cili komision bënte paraqitjen dhe arsyetimin e listës së zonës

operative. Në tre mënyra, vërtetohet se si ka shkuar procedura e verifikimit nëpër zona operative në territorin e Republikës së Kosovës. Çdo aplikacion, ishte nënshkruar nga zingjiri komandues përfshirë edhe nga Komandanti i zonës operative, ndërsa aplikacioni përmbante shënimin se përgjegjësia për të dhëna të rreme, ishte personale. Gjithashtu, komisioni kishte vepruar drejtë sa i përket ligjit të aplikueshëm, të cilat ishin në fuqi. Ligji i mëvonshëm nuk e kishte shfuqizuar ligjin asnjëherë dhe për këtë arsye komisioni ishte i detyruar të aplikojë rregulla të cilat ishin në favor të rasteve të aplikimit, pra komisioni ishte në pamundësi që të diskriminonjë aplikuesit, duke zbatuar rregulla të cilat do të ishin më pak të favorshme në krahasim me ligjin tjetër, i cili po ashtu ishte në fuqi. Andaj, në këto rrethana mbrojtja propozon si më lartë.

Në përgjigjen në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të paraqitur nga mbrojtësi i të akuzuarit N.L. avokati Tathir Rrecaj, theksohet se në ankesë nuk përmendet se cilat fakte dhe për çfarë arsye janë vërtetuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë. Në arsyetimin e ankesës, prokuroria ka paraqitur arsye në mënyrë të përgjithësuar. Prokuroria pretendon se vepra është kryer në periudhën kohore 28 tetor 2011 deri më 30 janar 2017, ndërkaq nga gjendja e fakteve rezulton se i akuzuari asnjëherë nuk ishte caktuar me vendim të Qeverisë së Kosovës, që të jetë anëtar i KVSH-së, por ka marrë pjesë në mbledhjen e 26-të të komisionit, si përfaqësues i ZO të Drenicës, i autorizuar nga S.L. anëtar i KVSH-së, në bazë vullnetare, çka vërtetohet nga provat materiale të cilave iu referohet në përgjigjen në ankesë. Më tutje, lidhur me deklaratën e dëshmitarit S.L. procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i dt.24.12.2019, sqarohet një fakt i tillë. Ndërsa, nga deklarata e të akuzuarit A.Ç., në mbrojtjen e dhënë më 13 tetor 2020, ka deklaruar rrethana të ngjashme. Me asnjë vendim të Qeverisë, nuk rezulton të jetë emëruar i akuzuari N.. Ndërsa, nga deklarata e dëshmitarit B.SH., ka vërtetuar se zëvendësimet që janë bërë në KVSH, janë bërë me vendim të Qeverisë. Rrjedhimisht, i akuzuari nuk e ka pasur cilësinë e personit zyrtar dhe nuk ka qenë asnjëherë person përgjegjës, apo të ketë pasur autorizim për të bërë kategorizimin në veteran luftëtar të UÇK-së. Prandaj, mos përkufizimi i saktë i veprës penale shkel dispozitat e nenit 2 par.3 të KPRK-së. Përkundër, se i akuzuari N., akuzohet për bashkëkryerje me asnjë pretendim dhe provë nuk është provuar të jetë plotësuar kushti ligjor i nenit 31 të KPRK-së, ku mbrojtja bën një përshkrim të kësaj dispozite ligjore. Duke marrë parasysh, se asnjë provë nuk e ka vërtetuar faktin se i akuzuari të jetë përfshirë në çfarëdo mënyrë në kryerjen e veprës penale, por e gjitha ka mbetur në nivel të dyshimeve dhe supozimeve. Mbrojtja i lidhur me pranimin e thashethemeve, i referohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Blastland kundër Mbretërisë së Bashkuar vendimi 52 DR 273,

dhe në rastin Unterpertinger kundër Austrisë vendimi i dt.24.11.1986. Gjithashtu, theksohet se përfshira e të akuzuarit nuk vërtetohet as me transkriptin e audio incizimeve që iu referohet PSRK (aktakuza faqe 31 deri 35), por as me provat tjera materiale. Mbrojtja liston disa fakte të pakontestuara në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, lidhur me atë se i akuzuari nuk ka ndërmarrë asnjë veprim inkriminues. Andaj, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar ligjin penal sepse prokuroria nuk ka provuar ekzistimin e kushtit objektiv dhe subjektiv lidhur me nenin 422 të KPRK-së. Si përfundim, thekson se prova përtej dyshimit të bazuar është standardi më i lartë i provës që duhet të përmbushet në çdo lloj gjykimi dhe prokuroria duhet të vërtetojë përtej dyshimit të arsyeshëm se personi ka kryer veprën penale. Në këto rrethana, mbrojtja ka propozuar si më lartë.

Në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ka paraqitur përgjigje mbrojtësi i të akuzuarit Q.G. avokati Gafurr Elshani, në të cilën theksohet se pretendimet e prokurorisë janë të pabazuara në prova dhe fakte dhe me administrimin e provave nuk është arritur të provohet se i akuzuari e ka kryer veprën penale, ashtu si edhe me ankesë nuk është konstatuar asnjë shkelje ligjore me rastin e marrjes së aktgjykimit lirues. Gjukata e shkallës së parë, me të drejtë ka konstatuar se prokuroria ka dështuar të vërtetojë saktë dhe në mënyrë të plotë periudhën kohore të veprimeve inkriminuese të akuzuarve, se në bazë të cilit ligj ishte bërë kategorizimi i statusit të veteranëve të luftës, se nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë marrë vendime në kundërshtim me ligj, se a ishte bërë apo jo verifikimi sipas udhëzimeve të KVSH-së nga Zona Operative, përgjegjësia nuk mund ti bartet të akuzuarve dhe organi i akuzës nuk ka mundur të dëshmojë se a ishin në kompetencë të detyrave të akuzuarve si persona zyrtar të verifikojë secilin aplikacion të aplikuesve. Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me numër 04/37 rezulton se mandati i KVSH-së ka përfunduar me datë 13.05.2016, ku edhe pushon së ekzistuar statusi i personit zyrtar, andaj çdo veprim i ndërmarrë pas kësaj date nuk mund ti atribuohet të akuzuarve. Listat nuk janë të përfunduara dhe komisioni i ka lënë mundësi Qeverisë, të veprojë konform dispozitave ligjore nëse do të kishte dyshime se procesi nuk kishte shkuar në rregull. PSRK-ja, ka dështuar të provojë në mënyrë të saktë dhe të plotë se numri prej 19 500 aplikuesve veteran luftëtar, a janë vërtetë përfitues të kundërligjshëm apo jo. Qëllimi i aplikuesve të KVSH-së, ishte që procesi të përfundonte siç ishte përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Andaj, duke marrë parasysh aktgjykimin e ankimuar, i njëjti sipas mbrojtjes është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe me ankesë nuk është vërtetuar asnjë shkelje ligjore.

Në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ka paraqitur përgjigje mbrojtësi i të akuzuarit RR.B. avokati Artan Qerkini, theksohet se prokuroria fare nuk ka marrë parasysh faktin se UÇK, nuk ka qenë ushtri e rregullt dhe konvencionale me një strukturë të qartë komanduese dhe organizimi i saj është bërë në baza vullnetare, formacion ushtarak i cili ka luftuar kundër një kundërshtari i cili në vitet 1998-1999, është konsideruar ushtria e 7 në Evropës dhe se formalitetet për evidentimin dhe regjistrimin e ushtarëve nuk i është kushtuar rëndësi. Kështu, theksohet se prokuroria nuk merr parasysh faktin se Zonat Operative të UÇK-së, nuk kanë pasur ndërveprim dhe veprimet kanë qenë të izoluar nga njëra tjetra dhe komandantët e një zone nuk kanë pasur mundësi ti njohin ushtarët e zonës tjetër, e as të zonës së tyre. Më tutje, mbrojtja i është referuar praktikës ndërkombëtare konkretisht çështjes penale në Tribunalin për ish Jugosllavi, rasti H.B. me numër 132/1805 QUATE. Sipas mbrojtjet, pretendimet ankimore të prokurorisë janë të pabazuara, sepse gjykata nuk ka mundur të intervenojë ex officio në përcaktimin e kohës së kryerjes së veprës së pretenduar, sepse do të kishim tejkalim të akuzës që do të paraqiste shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Më tutje, theksohet se PSRK, është munduar ti minimizojë dallimet në mes të Ligjit 04/L-054 dhe Ligjit 04/L-261, duke theksuar se ky i fundit vetëm sa e plotëson ligjin paraprak, sepse Ligji 04/L-261 vetëm rregullon beneficionet e kategorive të dala nga lufta, e që në këtë rast nuk janë kontestuese beneficionet dhe lartësia e tyre, por e drejta në këto beneficione. Më tutje, pretendohet se të drejtën e beneficioneve në formë të pagesave mujore, e kanë pas “veteranët luftëtarë”, por PSRK, qëllimisht hesht faktin se këto dy ligje në mënyrë të ndryshme e kanë definuar nocionin e “veteranit”, përderisa nocioni që ka përdorë PSRK me qëllim të mbështetjes së akuzës ka qenë nocioni që ofron Ligji 04/L-261, i cili është shumë më restriktiv e për këtë më i pafavorshëm për të akuzuarit, se nocioni që e definojnë në këtë kategori i parashikuar në Ligjin 04/L-054. Sipas mbrojtjes, PSRK pretendon se të akuzuarit nuk kanë pas dileme se cili ligj duhet të zbatohet, gjë që nuk është e vërtetë dhe demantohet nga deklarata e të akuzuarit A.Ç., e dhënë në shqyrtim gjyqësor ku ka theksuar se dilemat kanë ekzistuar, e sidomos kur janë shqyrtuar ankesat e personave. Për më tepër, gjykata kujdeset ex officio për zbatimin e ligjit pavarësisht prej interpretimit të ligjit që e bëjnë organet administrative siç në fakt ka qenë edhe KVSH-ja, sepse gjykata është autoriteti përfundimtar për zbatimin dhe interpretimin e ligjit. Gjithashtu, PSRK nuk ka dhënë sqarim se si ka ardhur tek përfundimi se 19.500 veteran luftëtarë nuk i plotësojnë kushtet për këtë status kur nuk dihet se ky numër a është marrë nga 46,230 veteran “të aprovuar”, apo nga totali i aplikacioneve të konfiskuara gjatë bastisjes. Kjo do të thotë se në mesin e veteranëve të kontestuar nga PSRK-ja, mund të kenë qenë edhe veteranët e refuzuar nga KVSH-ja. Sipas mbrojtjes, nuk ka mundësi të

shqiptohet aktgjykim dënues në rastin konkret, përderisa veteranët e pretenduar si të kundërligjshëm të mos dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë. Sipas përgjigjes, metodologjia e përdorur nga KVSH-ja, ka qenë e vetmja e mundshme në mënyrë që të bëhet verifikimi i veteranëve luftëtarë, e cila është vërtetuar edhe me deklaratat e dëshmitarëve të Prokurorisë. I akuzuari nuk ka pasur mundësi të vendoste se një veteran luftëtar a e meriton statusin në Zonën e Karadakut apo të Llapit, kur asnjëherë nuk i ka vizituar këto zona, prandaj metodologjia e verifikimit nga “zinxhiri komandues”, ka qenë e vetmja e mundshme për verifikimin e statusit të veteranëve të luftës. Duhet pasur parasysh, se asnjëri nga të akuzuarit nuk po akuzohet për zonën e tij të përgjegjësisë, por për numrin total të veteranëve luftëtarë pavarësisht nga zona në të cilën vijnë. Mbrojtja, paraqet mospajtim edhe me qëndrimin e PSRK-së, se ka konflikt interesi nëse ankesa trajtohet nga i njëjti organ, sepse procedura të tilla kemi edhe në procedura gjyqësore. Faktin, se ankesa mund ti drejtohet edhe organit i cili e ka nxjerrë aktin administrativ e vërteton edhe përmbajtja e nenit 128 të Ligjit për Procedurën Administrative. Gjithashtu, theksohet se mos nënshkrimi i faqes 3 të aplikacionit nuk paraqet vepër penale, sepse ky nënshkrim nuk është kërkuar në bazë të ligjit, për më shumë metodologjia e punës e përdorur nga KVSH, nuk ka lejuar që një anëtar i KVSH të nënshkruajë formularin e një veterani që nuk vinte nga zona e tij. Ndërsa, PSKR-ja, është munduar që të keqinterpretojë fjalët e të akuzuarit A.Ç. në mbledhjen e 27 të KVSH-së të dt.09.03.2016, e cila sipas mbrojtjes është në linjë me metodologjinë e punës së KVSH-së, sepse e ka pasur fjalën për anëtarët e KVSH-së që janë pjesë e saj e që përfaqësojnë zonat operative. Po ashtu mbrojtja propozon që deklarata e të akuzuarit dhe fjala përfundimtare e dorëzuar me shkrim të konsiderohen pjesë përbërëse e përgjigjes në ankesë. Në këto rrethana, mbrojtja ka propozuar si më lartë.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit S.E. avokati Nysret Islami, theksohet se vendimi i gjykatës është i drejtë, i arsyetuar mirë dhe në përputhje me të gjitha provat dhe deklaratimet në seanca, ndërsa aktgjykimi është arsyetuar në çdo pikë dhe në përputhje me dispozitat e kodit të procedurës penale, po ashtu dispozitivi nuk përmban paqartësi dhe është i arsyetuar në mënyrën e duhur. Pretendimet e prokurorit, për vërtetimin e gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, nuk qëndrojnë dhe janë vetëm përpyetje për mbrojtjen dhe arsyetimin e aktakuzës pa argumente. Prandaj, sipas mbrojtjes nuk është argumentuar koha e kryerjes së veprës penale, për më tepër kur i akuzuari S. nuk ka qenë pjesë e komisionit në kohën kur prokuroria pretendon se ka filluar kryerja e veprës penale. Lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, që përmenden

në ankesë sipas mbrojtjes nuk qëndrojnë, për faktin se janë mbajtur shumë seanca dhe janë vërtetuar faktet dhe provat në të cilat është mbështetur aktgjykimi. I akuzuari ka vepruar brenda kompetencave në kuadër të ligjeve dhe rregulloreve. Nuk është arsyetuar ankesa e prokurorisë, andaj mbrojtja konsideron që aktgjykimi nuk është i përfshirë me asnjë shkelje, por vendimi i gjykatës është i plotë, i kuptueshëm dhe nuk ka kontradikta, andaj edhe ka ardhur tek përfundimi i drejtë dhe real.

➤ *Gjetjet e gjykatës lidhur me pretendimet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale*

Pretendimet e prokurorisë lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, kolegji i kësaj Gjykate i gjen si të bazuara.

Kolegji vlerëson se Aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk përmban arsye të qarta për faktet vendimtare, se ka kundërthënë ndërmjet fakteve të përshkruara në dispozitiv dhe arsyeve të dhëna në aktgjykimin e ankimuar, se aktgjykimi nuk jap arsye të veçantë për sa i përket provave kundërthënëse dhe fakteve në dispozitiv të aktgjykimit, po ashtu arsyet në të cilat është bazuar në rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, po ashtu arsyet e dhëna veçanërisht lidhur me ekzistimin dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarve, të gjitha këto shkelje ndërlidhen me nenin 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 lidhur me nenin 370 paragrafi 7 të KPP-ës, të cilat në vijim do të argumentohen këto shkelje që kolegji i ka vlerësuar.

Kolegji vlerëson se, aktgjykimi i ankimuar sa i përket arsyeve që jepen në aktgjykim për provat që janë administruar, aktgjykimi nuk përmban arsye, siç përcaktohet me dispozitën nga neni 370 paragrafi 7, që kërkohet arsye për provat kundërthënëse, qoftë ndërmjet provave si tërësi apo të një prove në raport me faktet.

Sa i përket arsyeve të dhëna në aktgjykimin e ankimuar, ku konstatohet se, deklaratat e dhëna në fazat e mëhershme të procedurës penale nga të pandehurit nuk do të shqyrtohen si prova, kolegji vlerëson se, në procedurën gjyqësore nuk janë administruar provat që janë propozuar nga prokuroria. Fillimisht kolegji i kësaj Gjykate nuk pranon një arsyetim të tille se provat – deklaratat e dhëna nga të pandehurit, janë prova të papranueshme, për arsye se:

- Të akuzuarit me rastin e marrjes në pyetje, njoftohen për të drejtën e tyre të heshtjes dhe po ashtu njoftohen se deklaratat e dhëna nga ana e tyre mund të përdoren si prova

në procedurë, gjë që me rastin e marrjes në pyetje në fazën e hetimeve të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me këto të drejta, dhe rrjedhimisht kanë pranuar që të deklarohen.

- Fakti se në shqyrtim gjyqësor ata nuk pranojnë që të deklarohen, duke shfrytëzuar të drejtën e tyre për tu mbrojtur në heshtje, kjo e drejtë nuk mund të ketë efekt të veprimit procedural të mëhershëm kur ata janë deklaruar. Arsyeimi se e drejta e heshtjes në fazë më të vonshme të procedurës duke i dhënë peshë edhe për fazën e mëhershme kur kanë pranuar të deklarohen, përbën zbatim të gabuar të dispozitës procedurale që i garanton heshtje të akuzuarit, rrjedhimisht kjo mund ta vë në pozitë të pabarabartë në raport me faktet, sepse pikërisht në kohën kur ka pranuar që të deklarohet ai ka qenë i njoftuar dhe ai më së miri e din se për cilat fakte është deklaruar gjë që faktet e tilla mund të jenë të trajtuara edhe në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata e Apelit nuk pranon qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë kur bënë vlerësimin e deklaratave të të pandehurit mbështetur në nenin 262 paragrafin 1 dhe 2 dhe argumenton se këto deklarata janë të papranueshme. Fillimisht dispozita nga neni 261 përcakton se deklarata e mëparshme e dhënë nga i pandehuri mund të jetë provë e pranueshme nëse është marrë në mbështetje me nenin, 73, 131 ose 132. Ndërsa, kjo deklaratë e dhënë në procedurë të mëparshme mund të përdoret në dy situata: 1. Për ta kundërshtuar deklaratën e të pandehurit kur ai deklarohet në shqyrtim gjyqësor si provë e drejtpërdrejt, dhe 2. Si provë në mbështetje të nenit 262. Nga këto rrjedhë se deklaratimet e të pandehurve në procedurën paraprake janë të pranueshme kur ato janë marrë sipas nenit 73, 131 apo 132 (gjë që nuk ka ndonjë rrethanë që këto deklarime të jenë marrë në kundërshtim me nenin 131), dhe përderisa ato janë të pranueshme rrjedhimisht duhet edhe të administrohen në shqyrtimin gjyqësor. Ndërsa, kushtet e vlerësimit të këtyre deklaratave në raport me faktet që i vihen të akuzuarit në barrë, i përcakton neni 262 që kusht është se, deklaratës së tillë të të pandehurit, nuk mund t'i jepet forca provuese për ta provuar fajësinë duke u mbështetur ***vetëm në deklaratën e tillë apo duke i dhënë rëndësi vendimtare për faktet vetëm deklaratës së tillë***, që është dhënë nga i pandehuri.
- Bazuar në këto arsye kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, nuk ka administruar provat sipas dispozitave ligjore kur ka vendosur që deklarata e të pandehurve që janë dhënë në fazat para shqyrtimit gjyqësor, dhe ka vendosur që këto deklarata nuk mund të përdoren, pasi që një arsyeim i tillë rezulton në mënyrë të drejtpërdrejtë në kundërshtim me nenin 261 dhe 262 të Kodit të procedurës Penale, sepse deklarata e tilla nuk mund të konsiderohen të papranueshme, ato janë prova të pranueshme por si të tilla

kushtëzohen për tu vlerësuar mbështetur në standardin e të provuarit për fajësinë sipas kushteve të nenit 262 paragrafi 2, e cila dispozitë kushtëzon Gjykatën që të mos mbështetet për fajësinë e të akuzuarit vetëm në deklaratën e të akuzuarit apo duke mos dhënë rëndësi vendimtare deklaratës së tillë të të akuzuarit, rrjedhimisht ky kolegji nuk pranon arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë se këto deklarata të dhëna nga të akuzuarit janë të papranueshme, pasi që ato janë të pranueshme por si të tilla kanë specifika të forcës provuese dhe vlerësimit të provueshmërisë së fakteve, andaj ato si të tilla duhet të administrohen nga se janë të pranueshme.

Kolegji i Gjykatës se Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, kur arsyeton vendimet e marra nga të akuzuarit në cilësinë e anëtarëve të Komisionit Shtetëror, i referohet aspektit të dispozitave Ligjore, të Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëmarrësve të ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe Familjarëve të tyre, nr. 04/L-054, si dhe përkufizimeve që janë dhënë në kuadër të këtij ligji për statusin e veteranëve. *Megjithatë po ky ligj ne nenin 12 ka përcaktuar dy paragraf: 1.Sipas dispozitave te këtij ligji, nga Organi përgjegjës i Qeverisë njihet dhe përcaktohet statusi i veteraneve të UÇK-ës. 2.Te drejtat në beneficione për veteranët e UÇK-ës, si dhe kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre do të rregullohen me ligj të veçantë.*

Duke qenë se vet ligji që Gjykata e Shkallës së parë ka përcaktuar se me një ligj të veçantë do të njihet dhe përcaktohet statusi i veteranëve të UÇK-ës, dhe duke qenë se po me ligjin e veçantë përcaktohen beneficionet dhe kriteret kualifikuese për njohjen dhe realizimin e tyre, për gjykatën e Apelit rrjedhë se, arsyet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së parë, janë të paqëndrueshme kur argumentohet se Komisioni ka zbatuar Ligjin nr. 04/L-054, kjo për faktin se, me date 23.04.2014 është miratuar ligji nr. 04/L-261 “për Veteranet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, i cili ligj ne nenin 2 përcakton se Fushëveprimi i këtij ligji është me referencën ligjore ne nenin 12 (e cila dispozite ka përcaktuar se kjo sferë rregullohet me ligjin e veçantë), te ligjit ne. 04/L-054. Rrjedhimisht arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, për veprimet e të akuzuarve se kanë vepruar me ligjin tjetër janë në kundërshtim me faktet thelbësore të kësaj çështje penale, kjo për faktin se të gjitha aplikimet e parashtruara pranë Komisionit, nuk ishin miratuar listat e tilla para se të hynte ne fuqi ligji nr. 04/L-261, por se listat ishin miratuar nga Komisioni kur edhe kishte paraqitur raportin me shkrim me datë 17.05.2016, me nr. protokolli. 1737, çka do të thotë se përfundimi i listave nga Komisioni nuk ishte bërë para hyrjes në Fuqi te ligjit 04/L-261, prandaj arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, janë në

kundërshtim me tërësinë e provave kur argumenton se veprimet ishin ndërmarr sipas ligjit paraprak, për më tepër provat që janë administruar Procesverbalet e mbledhjeve të komisionit – incizimet audio, vet të akuzuarit dëgjohen se ishin në përpjekje që të sigurojnë përkrahjen në Kuvendin e Kosovës për ta nxjerrë ligjin e ri nga se ligji që ishte në fuqi kishte pengesa në zbatim, çka do të thotë se arsyet e dhëna nga gjykata se vendimet janë marrë nga Komisioni sipas ligjit paraprak përveç se rezultojnë në kundërshtim me faktet thelbësore të çështjes njëkohësisht rezultojnë se janë në shpërputhje edhe me provat materiale përkatësisht audio incizimet. Në këtë kuptim, duke mos argumentuar aspektet kundërthënëse për provat dhe për faktet ky Kolegj vlerëson se aktgjykimi është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 lidhur me nenin 370 paragrafi 7 e lidhur me nenin 361 të vlerësimit të provave një nga një dhe në lidhshmërinë e tyre të tërësishme.

Gjykata e Apelit po ashtu vlerëson se arsyet e dhëna në aktgjykimin e ankimuar nga gjykata e shkallës së parë, rezultojnë se janë të paqarta dhe në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimit si dhe provat që gjinden në shkresat e lëndës, lidhur me faktin e shqyrtimit të ankesave në procedurën e aplikuesve për njohjen e të drejtës së veteranit. Gjykata në arsyet e dhëna në aktgjykim (faqe 60-61), sipas së cilit konstaton se Komisioni kishte caktuar komisionin për shqyrtimin e ankesave sipas rregullores, kjo Gjykatë një arsyetim të tillë e gjen të paqëndrueshëm në raport me dispozitat ligjore, pasi që, sipas ligjit nr. 04/L-261 neni 7 nuk përcakton një komision të veçantë për shqyrtimin e ankesave, në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë arsyet që i ka dhënë janë të paqarta se Komisioni për shqyrtimin e ankesave a është dashur që të përbëhet nga anëtarët që nuk janë anëtarë të Komisionit apo që nuk kanë marr pjesë në shqyrtimin e listave. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye lidhur me kërkesat – aplikacionet për veteranët e luftës që sipas dispozitës ligjore të nenit 39, e cila ka paraparë se, të gjitha kërkesat e paraqitura në Komision të cilat janë në shqyrtim pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të kategorizohen sipas dispozitave të këtij ligji, ndërsa paragrafi 2 i nenit 39, përcakton se, të drejtat e përcaktuara në këtë ligj janë të pranueshme vetëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa në aktgjykimin e ankimuar përkundër se Gjykata konstaton se listat janë miratuar nga Komisioni me datë, 17.05.2016 sipas raportit nr. 1737 (ne kohen kur ligji nr.261 ishte në fuqi), prandaj për gjykatën e Apelit arsyet e dhëna nga Gjykata e shkallës së parë nuk gjejnë mbështetje në dispozitat ligjore të ligjit që ka qenë në fuqi kur janë miratuar listat nga Komisioni, të gjitha këto e bëjnë aktgjykimin që të jetë marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 lidhur me nenin

370 paragrafi 7 e cila dispozitë kërkon që Gjykata të paraqesë në mënyrë të qartë dhe të plotë arsyet se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara.

Gjykata po ashtu vlerëson se aktgjykimi i ankimuar rezulton se është marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjegjësisht në cenim të nenit 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12, lidhur me nenin 370 paragrafi 7 e cila dispozitë kërkon që gjykata në mënyrë të veçantë arsyeton provat kundërthënëse, e kjo ndërlidhet me deklaratat e dëshmitarëve në raport me dispozitat ligjore të ligjit 261, gjë që sipas këtij ligji parashihet se komisioni qeveritar shqyrton ankesat e pretenduara, mirëpo siç rezulton nga deklaratat e dëshmitarit, por edhe nga faktet e çështjes penale, ankesat nuk ishin shqyrtuar nga komisioni Qeveritar por se ato ankesa ishin shqyrtuar nga zingjiri komandues i zonës përkatëse, rrjedhimisht gjykata fare nuk lëshohet në vlerësimin e deklaratave të tilla si prova kur dëshmitari B.B. deklaroi se ankesat janë shqyrtuar nga zingjiri komandues përkundër se në Komisionin Qeveritar ishte propozuar që ankesat të shqyrtoheshin nga Komisioni Qeveritar, kjo përveç se përbën shkelje të dispozitave të procedurës penale që aktgjykimin e bën juridikisht të paqëndrueshëm njëkohësisht e reflekton edhe vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike. Për më tepër, në raport me deklaratën e dëshmitarit B., gjykata fare nuk vlerëson deklaratimet e tij që ishte pjesë e zyrës së sekretarisë së Komisionit, i cili kishte deklaruar se vendimet e marra nga komisioni Qeveritar nuk ishin në përputhje me ligjin 261. Po ashtu, lidhur me deklaratimet e dëshmitarit, A.RR., që ka deklaruar lidhur me komisionin për shqyrtimin e ankesave, ku thekson, “ ka qenë nën komisionin e përbërë nga, D., H., F., B. dhe vet ky dëshmitar, e ku kanë qenë edhe tre persona nga zingjiri komandues i zonës së pestë”, e që ky dëshmitar thekson se si rezultat i presionit nga jashtë dhe prezencës së tre personave nga zona e pestë që të jenë në këtë komision ky dëshmitar është larguar nga pjesëmarrja e Komisionit, por po ashtu dëshmitari kur thekson se, si përfaqësues i Shtabit të TMK-ës, numri i përafërt i pjesëtarëve të UÇK-ës, ka qenë 35.000 – 36.000, mirëpo gjykata përkundër se këto deklarime të dëshmitarëve janë në kundërshtim me faktet që pretendon akuza të njëjtat nuk i arsyeton dhe nuk iu kushton vëmendje për mospërputhjet thelbësore që ekzistojnë si prova ndërmjet tyre, por edhe në mospërputhje me faktet. Po ashtu, në raport me deklaratën e dëshmitarit, M.K. i cili thekson se, në zonën e tij përveç personave të uniformuar statusi i veteranit luftëtar i është njohur edhe logjistikës, mjekësisë, rojës, nga se një ushtri pa prezencën e tyre nuk mund të funksionojë, çka rezulton se pretendimi i tillë ishte edhe në aktakuzë që ngarkoheshin të akuzuarit konkretisht në pasuesin 3 të dispozitivit të aktgjyimit, ndërsa ky dëshmitar pohon faktet e tilla, ndërsa gjykata konstaton lidhur me këtë dëshmitar se ia ka falur besimin por në anën tjetër konstaton se vendimet e Komisionit Qeveritar ishin brenda kornizës ligjore dhe konstaton se të akuzuarit nuk kanë kryer veprimet

që pretendohet në aktakuzë përkundër se dëshmitari pohon faktet e pretenduara në aktakuzë dhe përkundër se ia falë besimin këtij dëshmitari. Prandaj, të gjitha këto shfaqin mungesën e arsyeve në mënyrë të veçantë në aktgjykim kur ka kundërthënie ndërmjet provave dhe fakteve e që rezultojnë në shkelje të nenit 384, 1.12 lidhur me nenin 370.7 të Kodit të procedurës Penale të Kosovës.

Gjykata e Apelit vëren se, gjykata e shkallës në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor (faqe 17), të datës 16.01.2020 ka konstatuar administrimin e, “ 19.500 aplikacione të evidentuara të cilat janë identifikuar si të parregullta të cilat ndërlidhen me listën që gjinden në shtojcën 1, (CD 3 dhe 4). Nga kjo rrjedhë se gjykata ka administruar listën me emrat e personave, por jo aplikacionet që përbëjnë provë të drejtpërdrejt në raport me detyrat e të akuzuarve që ngarkohen, në mënyrë që të vërtetohet çdo rrethanë faktike që është e rëndësishme për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike.

Gjykata e Apelit nuk mund të pranoj arsyet e gjykatës se shkallës së parë, kur konstaton se deklaratimet e të akuzuarve në audio incizime janë shprehje e mendimit të lirë, sepse ato deklarim janë për punën zyrtare e që ndërlidhen me detyrën e tyre zyrtare që ata kanë qenë të ngarkuar ta kryejnë sipas vendimit për emërimin e tyre, rrjedhimisht arsyet e tilla janë në shkëputje të vlerësimit të provave nga neni 361 ku gjykata duhet të vlerësojë të gjitha provat një nga një dhe në lidhshmërinë e tyre.

➤ ***Gjetjet e Gjykatës lidhur me pretendimet për vërtetimin e gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike.***

Gjykata e Apelit fillimisht vlerëson se, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar faktin se të akuzuarit kur kanë vepruar kanë qenë dy ligje të veçanta në fuqi, kjo për shkak se Ligji nr.04/L-054, në nenin 12 ka përcaktuar rregullimin e kategorive dhe të beneficioneve me ligj të veçantë, gjë që ligji i veçantë nr.04/L-261 në nenin 2 përcakton fushëveprimin që e ndërlidhe se fushëveprimi i këtij ligji është i mbështetur në ligjin 054 në nenin 12 sipas së cilit nen parashihet nxjerrja e ligjit të ri. Duke qenë, se komisioni ka miratuar listat përfundimtare me date, 17.05.2016 sipas raportit nr. 1737 ku edhe i ka rekomanduar ato lista në Qeveri, rrjedhë se miratimi i listave ndërlidhet me ligjin e veçantë nr.261, në këtë kuptim ky Kolegj gjen se, gjykata ka vërtetuar në mënyrë të gabuar faktin më thelbësor që ka të bëjë me miratimin e listave nga komisioni, në këtë çështje penale kur mbështetet në normat ligjore sipas së cilave

të akuzuarit në cilësinë e anëtarëve të komisionit kanë vepruar dhe se kanë qenë dy ligje në fuqi kur kanë vepruar.

Në rrjedhë të këtyre vërtetimeve të gabuara të gjendjes faktike rezultojnë, po ashtu arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë kur thekson se, Komisioni ka nxjerr vendimet sipas ligjit 054, ndërsa provat konkretisht audioincizimet e mbledhjeve të Komisionit, ku dëgjohen anëtarët e Komisionit, të cilët që të gjithë pa përjashtim pajtohen që nuk kanë mundur të veprojnë me këtë ligj, pasi që duhet të nxjerrët ligji i ri për të vepruar lidhur me aplikacionet për njohjen e të drejtës së veteranëve të Luftës, ndërsa sipas audioincizimeve të mbledhjeve Kryetari i komisionit i akuzuari A.Ç. i njofton anëtarët e Komisionit se kanë qenë në Kuvendin e Kosovës dhe se draft ligji ka mbetur të shqyrtohet vetëm edhe në komisionin për të drejta të njeriut dhe pastaj do të kalojë në seancën e Kuvendit, të gjitha këto biseda rezultojnë qartësisht se të akuzuarit shfaqnin diskutimet mbi problemin e pamundësisë së zbatimit të ligjit nr. 04/L-054, ndërsa Gjykata konstaton se ata kanë zbatuar ligjin e tillë kur kanë nxjerrë vendimet.

Gjykata e Apelit duke vërejtur se si fakt vendimtar në aktgjykim është pretenduar nga Prokuroria se bëhet fjale për 19.500 aplikacione të cilat ndërlidhen me kategorizimin e këtyre aplikuesve, nga shkresat e lëndës rrjedhë se këto *aplikacione* nuk janë administruar si provë, por janë administruar listat si tërësi në numër prej 19.500. Rrjedhimisht duke mos u administruar si provë aplikacionet, gjykata nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike lidhur me këtë fakt vendimtar, nga se fakti këtu është shtruar se këto aplikacione sipas të dhënave që ato aplikacione mbajnë a janë këto aplikacione me përmbajtje siç pretendonte prokuroria, se ishin me kategori, “ Mbështetje politike, Logjistike, financiare, mbështetje mjekësore, dhe detyra tjera të caktuara nga komandantet e njësisë, shtabeve dhe zonave të UÇK. Rrjedhimisht duke mos administruar aplikacionet për të verifikuar pretendimin e tillë, kjo rezulton në vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike, rrjedhimisht duke mos i administruar si provë nuk janë vërtetuar në mënyrë të drejtë faktet edhe sa i përket pretendimeve të prokurorisë, se aplikacionet kanë qenë vetëm me emër dhe mbiemër dhe nuk kanë qenë të nënshkruara.

Gjykata duke mos administruar aplikacionet e theksuara në dispozitivin e aktgjykimit, rezulton se nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë pretendimin e faktit se a ishin të përfshirë persona që pretendohet se ishin të mitur gjatë kohës së luftës në Kosovë dhe personave që ishin pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc dhe Ushtrisë Çlirimtare në Maqedoni, sepse faktet e tilla mund të vërtetohen në mënyrë të plotë vetëm kur administrohen

aplikacionet e pretenduara nga prokuroria në numrin prej 19.500 të cilat aplikacione kanë të shënuar edhe kategorinë se ku aplikuesi ka bërë pjesë.

Gjykata nuk e ka vërtetuar drejtë faktin kur ka konstatuar se, sipas metodologjisë së punës është krijuar komisioni për shqyrtimin e ankesave, përderisa siç rezulton nga dispozitat ligjore të ligjit 261, shqyrtimin e ankesave e bën Komisioni dhe jo një komision dytësor, që siç rezulton nga shkresat e lëndës, në kuadër të komisionit të ankesave kanë marrë pjesë anëtarë të komisionit (si përfaqësues të zonave) dhe persona që nuk kanë qenë pjesë e Komisionit Qeveritar (persona këta që kanë ardhur nga ajo zonë, por se nuk rezulton me ndonjë vendim se kanë qenë të caktuar si anëtar të komisionit për shqyrtimin e ankesave), përderisa dispozita ligjore nga neni 7 i ligjit nr. 261 ka përcaktuar se vendimi i Komisionit është përfundimtar, prandaj fakti i tillë duke argumentuar në metodologji të punës së komisionit rrjedhë se është vërtetim i gabuar, pasi që dispozita ligjore përcakton se Komisioni shqyrton ankesat, për më tepër kjo rrethanë ndërlidhet edhe me provat që janë administruar konkretisht me deklaratën e dëshmitarit B., që ka sqaruar mbi mënyrën si është vendosur dhe nga kush është vendosur për ankesat.

➤ *Udhëzimet për rigjykim në këtë çështje penale –*

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, duhet t'i administrojë provat e propozuara nga palët. Po ashtu duhet që t'i administroj aplikacionet që pretendon prokuroria, për të vërtetuar faktet se a janë:

Aplikacionet me pozita që nuk janë brenda kategorizimeve ligjore që pretendon prokuroria. Aplikacionet a kane të dhëna për persona të mitur gjegjësisht që aplikuesit kanë qenë të mitur në kohën e luftës.

A ka aplikacione që janë tërësisht me të dhëna të zbrazëta (përveç të dhënave personale) dhe sa është numri i tyre dhe a gjinden ata persona në listat përfundimtare.

Të kategorizohen aplikacionet në numrin e përgjithshëm prej 19.500, për secilën zonë që kanë aplikuar personat për t'iu njohur e drejta.

Të evidentohen personat përgjegjës (personat që kanë nënshkruar aplikacionet qoftë, si Mbikëqyrës, të njësisë, kompanisë, batalionit apo zonës) e kjo në raport me secilën zonë që janë aplikacionet prej 19.500 aplikimeve, dhe personat që kane konfirmuar me nënshkrimin e tyre aplikacionet e tilla të ftohen dhe të dëgjoen duke u ballafaquar me aplikacionet e tilla për të vërtetuar faktin se:

Nga aplikacionet a rezulton përshkrimi i pozitës së aplikuesit për tu vërtetuar që ata aplikues, a kanë qenë në cilësinë e mbështetjes, politike, logjistike, financiare, mjekësore, apo detyra të tjera gjatë periudhës 1997 – 1999, dhe faktet e tjera si aplikuesit në periudhën e tillë a ka qenë i mitur apo a ka marrë pjesë në luftërat e UÇPMB-ës apo në UÇK në Maqedoni, në mënyrë që të vërtetohet drejtë gjendja faktike.

Të ftohen në cilësi të dëshmitarit çdo person që rezulton nga të dhënat e aplikacioneve se gjatë periudhës së Luftës në Kosove kanë qenë në moshë të mitur, të merren në pyetje në drejtim të rrethanave, për rolin e tyre gjatë luftës, me qëllim që të vlerësohet fillimisht se a kanë qenë të angazhuar dhe pozita e tyre gjatë periudhës së luftës dhe varësisht nga pozita të vlerësohet se a janë brenda kategorive ligjore sipas ligjit nr. 261, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike.

Pasi që të administrohen të gjitha provat dhe të merren dhe administrohen edhe aplikacionet dhe dëshmitarët (personat përgjegjës) që kanë nënshkruar aplikacionet e tilla, atëherë të vlerësohen të gjitha një nga një dhe në lidhshmërinë e tyre në raport edhe me provat që gjinden në shkresat e lendes, deklarata e dëshmitarëve, audio incizimet.

Sa i përket të akuzuarit N.L. por edhe të akuzuarve të tjerë, të urdhërohet marrja e provës për Qeverinë, që Gjykatës t'i siguroj.

Të gjitha vendimet mbi përbërjen fillestare të anëtarëve të komisionit, çdo vendim mbi ndryshimet e anëtarëve të komisionit, secilën periudhe kohore që kanë qenë dhe kur janë zëvendësuar anëtarët e komisionit me vendime të Qeverisë dhe aktet e dorëheqjes nga cilido anëtar i Komisionit. Të vlerësohet se në çfarë cilësie ka marrë pjesë i akuzuari N.L., pasi që cilësia e personit zyrtar këtu gjen mbështetje vetëm nëse ka qenë i emëruar me vendim.

Gjykata në rigjykim po ashtu duhet t'i lexojë deklaratat e të akuzuarve që kanë shfrytëzuar të drejtën e heshtjes në shqyrtim gjyqësor (këto deklarata nuk konsiderohen prova të papranueshme), por që ato t'i vlerësojë në përputhje me nenin 262 të KPP-ës.

Gjykata po ashtu duhet t'i ketë parasysh të gjitha provat dhe njëkohësisht audioincizimet e të akuzuarve që diskutojnë gjatë mbledhjeve dhe këto të vlerësohen në raport me të gjitha provat që administrohen për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike.

Gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësojë se a kishin kompetencë ligjore anëtarët e Komisionit që të delegojnë kompetenca të personat tjerë apo të përfshijnë persona të tjerë jo të emëruar në komisioni nga Qeveria, për tu bërë pjesë e komisionit për shqyrtim të ankesave.

Pasi që t'i ndërmerret të gjitha këto veprime, dhe t'i administrojë të gjitha provat, ato në tërësi t'i vlerësojë, dhe të nxjerr vendim në përputhje me dispozitat ligjore.

Andaj Gjykata për arsyet e lartë theksuara e duke u bazuar në nenin 402 të Kodit të Procedurës Penale vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT NË KOSOVË

APS.nr. 20/2021, datë.21.03.2022

B.profesionale
Alba Makolli

Anëtarët e kolegjit
Burim Ademi

Kryetari i kolegjit,
Tomisllav Petroviq

Bashkim Hyseni